



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave – Ministarsvo za Finansije
Ministry of Finance

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarsvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Mjesia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 02 K007
Nr. Prot. / Prot. No.: 2154-1
Nr. i kopjeve / Broj stranica / No. pages: 7
Data / Datum / Date: 10.12.2020
Dallëse: PRISHTINE/A

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarsvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data / Datum / Date: 11.12.2020

Mjesia e organizimit	Nr. i Lëndës	Shojca	Vlera
-VI-	020-914/2		

Për:	Goran Rakić, Ministër i Pushtetit Lokal Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, MPL
Kopje:	Kryetari i Komunës së Kaçanikut Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL
Përmes:	Agim Krasniqi, Zv. Ministër i Ministrisë së Financave Enis Spahiu, Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave
Nga:	Bahrije Berisha, Zv. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave
Zyrtarët përgjegjës:	Razije Murtezaj, Departamentit Ligjor, Ministria e Financave Lumnije Hetemi, Departamenti i Tatimit në Pronë, Ministria e Financave
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr.104/02-29060/20 për Caktimin e Normave Tatimore për Tatimin në Pronën e paluajtshme për Vitin 2021

I nderuar Ministër, z. Rakić,
I nderuar Sekretarë i Përgjithshëm, z. Berisha,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) - NR. 07/2020, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01.Nr.104/02-29060/20 për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

I miratuar me datë: 23.11.2020.

I parashtruar për shqyrtim në MPL me datë: 27.11.2020.

I dërguar për shqyrtim në MF me datë: 30.11.2020, me nr.2154.

Në shqyrtimin e përmbajtjesor të aktit, Ministria e Financave vlerëson se akti në fjalë është në përputhje me *Nenin 9 Normat Tatimore të Ligjit Nr. 06/L-005 Tatimit në Pronë*, është kompetencë e komunës të caktoj normat tatimore, andaj Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe prodhon efekt juridik.

Me respekt.